



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Nr. 6719 prot.

Kamëz, më 30.6 .2021

NJOFTIM

MBI ZHVILLIMIN E DËGJESËS PUBLIKE ME GRUPET E INTERESIT DHE PUBLIKUN, NË LIDHJE ME RAPORTIN PARAPRAK TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM) PËR HARTIMIN E PLANIT TË PËRGJITHËM VENDOR.

Të nderuar,

Në kuadër të nismës së ndërmarrë për hartimin e Planit të Përgjithëm Vendor, Bashkia Kamëz në cilësinë e autoritetit propozues është angazhuar paralelisht në hartimin e raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për PPV-në, në zbatim të nenit 52 pika (2) të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” në të cilin citohet që: *“Gjatë fazave I, II dhe III hartohet paralelisht edhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor për PPV-të”*, dhe në bazë të shkresës datë 18.02.2021, protokolluar me tonën me nr.1782 prot., datë 22.02.2021 me lëndë “Kthim përgjigje në lidhje me njoftimin për marrjen e nismës për hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Kamëz” nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, e cila shprehet se PPV-ja duhet t’i nënshtohet procedurës së Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces sistematik që vlerëson pasojat në mjedis të një dokumenti strategjik planifikues të propozuar për zbatim me qëllim që të sigurojë që këto pasoja mjedisore të adresohen plotësisht që në fazat e hershme të vendimmarrjes përkrah konsideratave ekonomike dhe sociale. VSM-ja duhet të paraqesë informacione mbi ato ndikime mjedisore, ekzistenca dhe pasoja e të cilave nuk janë të përcaktuara me saktësi. Në këtë mënyrë VSM-ja në gjatë hartimit të dokumentave strategjik planifikues mund të kontribuojë për një përmirësim të procesit të planifikimit dhe vendimmarrjes, meqë është një vlerësim gjithëpërfshirës, sistematik dhe transparent i aspekteve mjedisore, sociale dhe ekonomike si dhe i implikimeve problematike të planifikimit.

Prandaj, konsiderohet si tepër e rëndësishme sigurimi i një process dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi me synim sugjerimin e çështjeve të ndryshme ,nga ana e grupeve të interesit dhe publikut.

Në përputhje me kuadrin ligjor dhe afatet kohore të parashikuara në Ligjin Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” dhe VKM-në Nr. 219, datë 11.3.2015 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun”, si dhe dëgjuesën e parë, ku u morën mendime, kritika, sugjerime, propozime që janë pasqyruar në raportin paraprak të VSM-së:

Bashkia Kamëz do të organizojë në ambjentet e saj ditën e Martë me datë 06.07.2021, ora 11:00, konsultimin e dytë me grupet e interesit dhe publikun për çështjet që janë trajtuar në raportin paraprak të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Pjesmarrja juaj aktive në këtë fazë do të ishte e dobishme për të diskutuar më konkretisht çështjet që janë adresuar dhe duhet të adresojë dokumenti i VSM-së .

Ndërkohë, në adresën <https://kamza.gov.al/drejtoria-e-urbanistikes/> mund të njiheni me raportin paraprak të VSM-së.

• Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

